



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 27 Prot.

Tiranë, më 21.04.2020

V E N D I M

Nr. 10, datë 21.04.2020

Për miratimin e Rregullore “Për Procedimin Disiplinor”.

Komisioni i Policisë Gjyqësore, i mbledhur sot në datën 21.04.2020, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nenin 35 dhe 36 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”,

V E N D O S I

Miratimin e Rregullore “Për Procedimin Disiplinor” të këtij Komisioni, në përputhje me tekstin bashkangjitur këtij vendimi.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

BLEDAR ÇELIKU

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

ERVIN BRAHAJ

ANËTAR

ALBERT MUÇO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

RREGULLORE

Nr. _____, Datë ____ . ____ .2019

PËR PROCEDIMIN DISIPLINOR

Në mbështetje të neneve 35 e 36 të Ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, pasi mori dhe miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm,

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

MIRATON KËTO RREGULLA:

Për procedimin disiplinor të oficerëve të policisë gjyqësore

Neni 1

Rregulla të Përgjithshme

1. Oficerët e Policisë Gjyqësore i nënshtrohen procedimit disiplinor sipas ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore".
2. Procedimi disiplinor u nënshtrohet parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit, mbrojtjes së të drejtave dhe kontradiktoritetit në përputhje me normat dhe garancitë e procesit të rregullt ligjor.
3. Si rregull, procedimi disiplinor është i pavarur nga procedimi penal i nisur ndaj oficerit të policisë gjyqësore ndaj të cilit kërkohet procedimi disiplinor dhe mund të zhvillohet paralelisht me të. Vetëm në rastet kur procedimi disiplinor është i varur nga faktet dhe rrethanat që priten të provohen nga procesi penal, për fillimin dhe ecurinë e procedimit disiplinor do të pritet përfundimi i procesit penal me vendim

të formës së prerë.

4. Kur gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor rezultojnë të dhëna që tregojnë se oficeri i policisë gjyqësore ka kryer një vepër penale, e cila, ndiqet kryesisht, Komisioni i Policisë Gjyqësore autorizon Kryetarin e Komisionit të paraqesë kallëzim penal në prokurorinë kompetente, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.
5. Ka konkurrim të shkeljeve disiplinore në rastet kur punonjësi i Policisë Gjyqësore kryen dy ose më shumë shkelje dhe kur vendimi që cakton masën disiplinore për njërën prej tyre nuk ka marrë ende formë të prerë.
6. Në rastin e konkurimit të shkeljeve disiplinore jepet një masë e vetme. Kur shkeljeve të konstatuara u përkohet masa të ndryshme disiplinore, nga Komisioni jepet masa më e rëndë.
7. Për caktimin e masës disiplinore mbahet parasysh rëndësia e faktit, forma, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes. Procedimi disiplinor ka karakter konfidencial. Ndalohet publikimi apo përhapja në çdo formë e të dhënave, gjersa oficeri i policisë gjyqësore i proceduar nuk ka marrë dijeni për to.

Neni 2

Subjektet që kanë të drejtë të propozojnë fillimin e procedimit disiplinor

1. Të drejtën për të kërkuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore e kanë:
 - a) Prokurori i Përgjithshëm.
 - b) Drejtuesi i Prokurorisë
 - c) Prokurori i çështjes për çështjen në të cilën është kryer shkelja disiplinore.
 - d) Titullari i institucionit shtetëror, të cilit, ligji i posaçëm i njeh funksionet e Policisë Gjyqësore.
2. Procedimi disiplinor fillon brenda 6 (gjashtë) muajve nga zbulimi i shkeljes, por jo më vonë se 3 (tre) vjet nga kryerja e saj.
Kalimi i çdonjërit prej këtyre dy afateve sjell shuarjen e përgjegjësisë disiplinore.
3. Momenti i zbulimit të shkeljes konsiderohet data në të cilën subjekti që ka të drejtën e propozimit për fillimin e procedimit disiplinor vjen në dijeni të shkeljes.

Neni 3

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor

1. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur:
 - a) Natyrën e shkeljes disiplinore, referuar në nenin 33 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
 - b) Faktet për të cilat kërkohet fillimi i procedimit disiplinor.
 - c) Provat që provojnë shkeljen disiplinore.
2. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor shoqërohet nga relacioni i procedimit disiplinor, i cili duhet të jetë i hollësishëm dhe në të, të jenë përshkruar në mënyrë të detajuar shkelja apo shkeljet disiplinore të pretenduara, veprimet konkrete të oficerit të policisë gjyqësore të cilat përbëjnë shkelje disiplinore dhe rrethanat në të cilat ato janë kryer.
3. Gjithashtu, kërkesa duhet të shoqërohet me të dhëna të tjera, që institucioni ku oficeri i policisë gjyqësore punon disponon, të cilat, kanë të bëjnë me vlerësimet e mëparshme të punës, personalitetin e oficerit të policisë gjyqësore, masat disiplinore të dhëna më parë ndaj tij si dhe çdo e dhënë tjetër që mund ti shërbejë procedimit disiplinor.

Neni 4

Përgatitja paraprake për nxjerrjen e Urdhërit për fillimin e procedimit disiplinor.

1. Komisioni i Policisë Gjyqësore ka detyrimin që brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës nga subjektet e përcaktuara në nenin 35 të ligjit 25/2019, të nxjerrë urdhërin për fillimin e procedimit disiplinor.
2. Brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 36 të ligjit 25/2019, Kryetari i Komisionit në bashkëpunim me Sekretariatën Teknik, marrin masat për përgatitjen dhe plotësimin në përputhje me kërkesat e ligjit të praktikës për kërkesën e paraqitur. Në funksion të plotësimit të materialit, Kryetari i Komisionit ka të drejtë të kërkojë nga subjekti propozues dhe institucioni i emërtesës së oficerit të policisë gjyqësore, të dhëna shtesë dhe dokumenta që i shërbejnë sqarimit dhe rrethanave të shkeljes ose shkeljeve disiplinore të pretenduar si dhe të dhëna të administruara në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore dhe që lidhen me vlerësimet e mëparshme të tij, masat

disiplinore të dhëna ndaj tij, dhe çdo të dhënë tjetër që i shërben procedimit disiplinor.

3. Në rastet kur kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji ose nuk shoqërohet me dokumentat apo të dhënat e përcaktuara në nenin 35 të ligjit 25/2019, Kryetari i Komisionit mund t'ia kthejë atë pa veprim subjektivit kërkuar ose mund të kërkojë prej tij plotësimin e kërkesës me të gjitha të dhënat e nevojshme.
4. Në rastet kur nuk është nxjerrë urdhëri për fillimin e procedimit disiplinor, në Komision paraqitet nga subjektet e caktuara në ligj një kërkesë tjetër për shkelje disiplinore të pa përfshira në kërkesën e mëparshme, për të njëjtin oficer të policisë gjyqësore, Kryetari i Komisionit në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik marri masat për plotësimin në përputhje me kërkesat e ligjit të kërkesës, pa shkelur afatin 30 ditor të parashikuar nga neni 36 i ligjit 25/2019. Kërkesat shqyrtohen në të njëjtën mbledhje dhe për shkeljet e pretenduara nxirret një urdhër i vetëm për fillimin e procedimit disiplinor.
5. Sekretariati Teknik merri masat e nevojshme dhe u vë në dispozicion anëtarëve të Komisionit kopje të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor së bashku me materialet shoqëruese të paktën tre ditë para datës së caktuar për mbledhjen e Komisionit.

Neni 5

Urdhëri për fillimin e procedimit disiplinor

1. Në mbledhjen në të cilën është parashikuar diskutimi i kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, Komisioni nxjerr urdhërin për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore për të cilin kërkohet fillimi i procedimit disiplinor.
2. Urdhëri për fillimin e procedimit disiplinor duhet të përmbajë në mënyrë të përmbledhur shkeljet disiplinore për të cilat duhet të fillohet procedimi disiplinor, natyra e tyre, parashikimi ligjor për to dhe faktet për të cilat duhet të fillohet procedimi disiplinor.
3. Urdhëri për fillimin e procedimit disiplinor shoqërohet nga relacioni shpjegues, i cili, për gatitet nga Kryetari i Komisionit ose një anëtar i tij. Relacioni shpjegues duhet të përmbajë:
 - a) të dhëna të detajuara për shkeljet e përmendura në urdhërin për fillimin e

procedimit disiplinor.

b) të dhëna të tjera, të administruara në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore që lidhen me vlerësimet e mëparshme, masat disiplinore të dhëna ndaj tij, tregues të tjerë që kanë të bëjnë me qëndrimin etiko-moral të oficerit të policisë gjyqësore dhe çdo e dhënë tjetër që i shërben procedimit disiplinor.

4. Pas marrjes së vendimit për nxjerrjen e urdhërit për fillimin e procedimit disiplinor, Komisioni cakton dhe datën se kur do të zhvillohet seanca për shqyrtimin e procedimit disiplinor. Në caktimin e kësaj date Komisioni duhet të mbajë parasysh kohën e nevojshme për njoftimin dhe njohjen me materialet e procedimit disiplinor, të oficerit të policisë gjyqësore dhe koha që i duhet për të përgatitur mbrojtjen e nevojshme, por jo më vonë se 30 ditë nga dalja e urdhërit.
5. Kur pas fillimit të procedimit disiplinor konstatohen shkelje të tjera të natyrës së parashikuar nga neni 33 i ligjit Nr. 25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" Komisioni urdhëron plotësimin e objektit të procedimit disiplinor. Oficerit të policisë gjyqësore të proceduar i jepet koha e mjaftueshme për të realizuar mbrojtjen e tij për objektin e shtuar.

Neni 6

Njohja e oficerit të policisë gjyqësore me urdhërin dhe dokumentacionin e procedimit.

1. Komisioni ka detyrimin që brënda 5 (pesë) ditëve nga nxjerrja e urdhërit për fillimin e procedimit disiplinor të njoftojë oficerin e policisë gjyqësore për shkaqet, faktet dhe dispozitat e shkelura si dhe datën e zhvillimit të seancës për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj tij.
Për datën e seancës për shqyrtimin disiplinor njoftohet dhe Subjekti propozues.
Kryetari i Komisionit mer masat për ti komunikuar oficerit të policisë gjyqësore, urdhrin për fillimin e procedimit disiplinor dhe relacionin shpjegues, si dhe i cakton një afat, jo më pak se 10 ditë, por jo më shumë se 20 ditë, për të përgatitur dhe paraqitur kundërshtimet e tij.
2. Njoftimi i oficerit të policisë gjyqësore bëhet nga Sekretariati Teknik ose nëpërmjet shërbimit postar, duke i dorëzuar kopjen e aktit të interesuarit. Në rast se njoftimi bëhet nga Sekretariati Teknik ose sekretaria e Institucionit ku oficeri i policisë gjyqësore është në marrëdhënie pune, dokumentimi i njohjes së tij me aktet e procedimit disiplinor kryhet nëpërmjet dëftesës së komunikimit, në të cilën, shënohet data e marrjes nga oficeri i policisë gjyqësore i akteve të procedimit disiplinor.

Njoftimi mund të bëhet edhe me mjete të tjera të përshtatshme që garantojnë njoftimin, me kusht që të dokumentojnë njohjen e oficerit të policisë gjyqësore me aktet e procedimit disiplinor.

3. Oficeri i policisë gjyqësore i proceduar ka detyrimin të pasqyrojë në dëftesën e njoftimit adresën e saktë të banimit. Në rast të ndryshimit të adresës së banimit duhet të njoftojë me shkrim Komisionin.

Neni 7

Të drejtat e oficerit të policisë gjyqësore të proceduar disiplinorisht

Oficeri i policisë gjyqësore ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor ka të drejtë:

- a. Të informohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar për faktet, shkeljet, dhe sanksionet që mund të vendosen ndaj tij.
- b. Të parashtojë kundërshtime, pretendime dhe kërkesa para Komisionit.
- c. Të njihet me gjithë dokumentacionin e procedimit disiplinor dhe provat mbi të cilat mbështetet procedimi disiplinor.
- d. Të paraqesë dhe të depozitojë në Komision prova që ai i konsideron të nevojshme për sqarimin e pozicionit të tij në raport me shkeljet disiplinore që i atribuohen.
- e. Të mbrohet vetë ose me një mbrojtës i zgjedhur prej tij.
- f. Të kërkojë thirjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve.
- g. Të paraqesë të dhëna të tjera për mbrojtjen e tij.

Neni 8

Njohja e anëtarëve të Komisionit me dokumentacionin e procedimit disiplinor.

1. Kryetari i Komisionit në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik vendos në dispozicion të çdo anëtari të Komisionit një kopje të dokumentacionit për procedimin disiplinor të oficerit të policisë gjyqësore, jo më vonë se tre ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e seancës për procedimin disiplinor.
2. Dokumentacioni i procedimit disiplinor përbëhet nga urdhëri për fillimin e procedimit disiplinor, relacioni shpjegues i shkeljeve, provat e depozituara nga propozuesi, të dhënat dhe dokumentat e administruara nga Sekretariati Teknik, dëftesa e komunikimit dhe aktet e mbrojtjes së oficerit të policisë gjyqësore të proceduar, nëse ky i fundit ka paraqitur.

Neni 9

Palët pjesëmarrëse në seancën për shqyrtimin disiplinor

Mbledhja e Komisionit të Policisë Gjyqësore për zhvillimin e seancës për procedimin disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore bëhet me pjesëmarrjen e:

- Anëtarëve të Komisionit të Policisë Gjyqësore. Për zhvillimin e mbledhjes kërkohet pjesëmarrja e detyrueshme e të paktën tre anëtarëve të Komisionit.
- Oficeri i policisë gjyqësore i proceduar dhe/ose avokati i zgjedhur prej tij.
- Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit propozues nëqoftëse ka konfirmuar pjesëmarrjen e tij.
- Punonjësi i Sekretariatit Teknik i ngarkuar për mbajtjen e procesverbalit të seancës së procedimit disiplinor.

Neni 10

Shqyrtimi i procedimit disiplinor nga Komisioni

1. Mbledhja për shqyrtimin e shkeljes ose shkeljeve disiplinore të pretenduara fillon me verifikimin e paraqitjes së palëve, verifikimin nëse oficeri i policisë gjyqësore është njohur me objektin e procedimit disiplinor dhe provat në ngarkim të tij.
2. Nëse oficeri i policisë gjyqësore ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor nuk është paraqitur, Komisioni shqyrton shkaqet e mosparaqitjes. Nëse nuk ka shkaqe të arsyeshme, Komisioni vazhdon seancën e procedimit disiplinor. Kur oficeri i policisë gjyqësore nuk paraqitet për shkaqe të arsyeshme Komisioni shtyn seancën për procedimin disiplinor për një datë tjetër, pasi të jetë shuar shkaku i mosparaqitjes.
3. Në vijim seanca vazhdon me parashtrimin hyrës të subjektit propozues dhe kërkesën e tij për marrjen dhe shqyrtimin e provave. Në rastet kur subjekti propozues nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën e procedimit disiplinor, parashtrimi i kërkesës së subjektit propozues bëhet nga Kryetari ose një prej anëtarëve të Komisionit.
4. Pas parashtrimit hyrës, i jepet fjala dhe dëgjohe oficeri i policisë gjyqësore i proceduar dhe/ose mbrojtësi i tij, të cilët, kanë të drejtë të paraqesin kundërshtimet e tyre dhe të kërkojnë marrjen e provave të reja.
5. Nëse palët e çmojnë të nevojshme, në ditën e caktuar për shqyrtimin e shkeljes, mund të kërkojnë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve, për të sjellë fakte rreth

çështjes. Oficeri i policisë gjyqësore dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm kur dëshmitarët sjellin fakte dhe t'i pyesin ata për faktet e sjella prej tyre.

6. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të drejtojë pyetje oficerit të policisë gjyqësore të proceduar për sqarimin e çështjeve që lidhen me objektin e procedimit disiplinor.
7. Gjatë shqyrtimit disiplinor duhet të zbatohet parimi i kontradiktoritetit. Komisioni është i detyruar të dëgjojë oficerin e policisë gjyqësore të proceduar disiplinarisht dhe të verifikojë pretendimet e ngritura prej tij. Në raste të veçanta, kur është e nevojshme, për verifikimin e pretendimeve të oficerit të policisë gjyqësore dhe marrjen e provave të reja, Komisioni mund të shtyjë seancën për një periudhë jo më shumë se 15 ditë.
Mbledhjet e Komisionit pasqyrohen në procesverbal në formë të përmbledhur.

Neni 11

Marrja e vendimit nga Komisioni

1. Komisioni para marrjes së vendimit verifikon edhe:
 - a) dokumentacionin e dosjes personale të oficerit të policisë gjyqësore.
 - b) praktikat dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;
 - c) praninë e faktorëve apo rrethanave rënduese ose lehtësuese, duke përfshirë, por pa u kufizuar, rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore, qëndrimin e oficerit ndaj shkeljes së kryer, pasojat e shkaktuara, etj;
 - d) përvojën dhe rezultatet individuale në ushtrimin e detyrës.
2. Pas shqyrtimit të fakteve dhe vlerësimit të provave, Komisioni jep vendimin për marrjen e masës disiplinore ose pushimin e procedimit disiplinor.
3. Vendimi i Komisionit merret me votim të hapur. Anëtarët e Komisionit që janë të pranishëm në mbledhje nuk mund të abstenojnë.
4. Para votimit secili nga anëtarët e Komisionit jep mendimin e tij në lidhje me procedimin disiplinor dhe masën disiplinore që duhet ti jepet oficerit të policisë gjyqësore që procedohet. Mendimet e shfaqura hidhen në votim. Mendimi që merr shumicën e votave përbën vendimin e Komisionit, i cili, duhet të pasqyrohet në një akt të shkruar.
5. Kur ka, vendimit për masë disiplinore dhe vendimit të pushimit u bashkëlidhet mendimi i pakicës. Vendimi i Komisionit u njoftohen palëve, me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Kryetari i Komisionit.

Neni 12

Përmbajtja e vendimit

Vendimi i Komisionit për dhënien e masës disiplinore ose pushimin e procedimit disiplinor jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

Vendimi për dhënien e masës disiplinore duhet të përmbajë si elementë përbërës të dhënat që tregojnë:

- a. Organin që ka marrë vendimin.
- b. Identitetin e oficerit të policisë gjyqësore ndaj të cilit është marrë masa.
- c. Shkeljet disiplinore të kryera.
- ç. Arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit.
- d. Masën disiplinore të marrë.
- dh. Bazën ligjore ku mbështetet vendimi dhe masa e marrë.
- e. Të drejtën që ka oficeri i policisë gjyqësore dhe subjekti që ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor, për tu ankuar dhe afatet e ankimit.

Neni 13

Pushimi i procedimit disiplinor

Procedimi disiplinor pushon me vendim të Komisionit, në rastet kur:

- a) Oficeri i policisë gjyqësore i proceduar vdes.
- b) Kur oficeri i policisë gjyqësore i proceduar jep dorëheqjen nga atributet apo funksioni dhe dorëheqja e tij pranohet nga organi i emërtesës.
- c) Kur pas fillimit dhe shqyrtimit të procedimit disiplinor nuk vërtetohen shkeljet e pretenduar ose ato nuk qëndrojnë.

Neni 14

Regjistri i procedimit disiplinor

Sekretariati Teknik pranë Komisionit të Policisë Gjyqësore mban regjistrin e procedimeve disiplinore, në të cilin, regjistrohet çdo urdhër i marrë nga Komisioni për fillimin e procedimit disiplinor si dhe çdo vendim i tij për dhënie mase disiplinore.

Neni 15

Administrimi i materialit të procedimit disiplinor

1. Masat e dhëna disiplinore, në çdo rast, bëhen pjesë e dosjes personale të oficerit të policisë gjyqësore. Ato shuhen në përputhje me afatet e parashikuara në ligj.
2. Për çdo procedim disiplinor formohet një fashikull i veçantë, i numërtuar sipas numrit respektiv të rregjistrimit të procedimeve disiplinore.
Fashikulli i procedimit disiplinor përmban të gjitha aktet që grumbullohen dhe formohen gjatë procedimit disiplinor.
Fashikulli i procedimit disiplinor mbahet nga Sekretariati Teknik i Komisionit.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

**KRYETARI
ALFRED PROGONATI**

**ANËTAR
BLEDAR ÇELIKU**

**ANËTAR
ERVIN BRAHAJ**

**ANËTAR
HARI GOGO**

**ANËTAR
ERIND GJONI**